

20110471293

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN
E LIGJIT PËR KULTURE

Neni 1

Në Ligjin për kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007 dhe 116/10) pas nenit 5 shtohet neni i ri 5-a, si vijon:

"Neni 5-a

Në procedurën e kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikeqyrje inspektuese nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe."

Neni 2

Nentitulli "Programi nacional" dhe neni 9, ndryshohen si vijojnë:

"Strategjia nacionale

Neni 9

(1) Për realizimin e interesit nacional në kulturë, Kuvendi i Republikës së Maqedonise miraton Strategjinë nacionale për zhvillimin e kultures për periudhë prej pesë vitesh.

(2) Strategjia nacionale për zhvillimin e kultures është dokument strategjik me të cilin përcaktohen qëllimet dhe prioritetet afatmesme të kultures dhe përcaktohen masa organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tyre (në tekstin e metejme: Strategjia nacionale).

(3) Strategjia nacionale përmban edhe Plan aksional për realizim me aktivitete, dinamike, bartes të aktiviteteve dhe projeksione të mjeteve buxhetore dhe jashtëbuxhetore të definuara, si dhe kushte dhe indikatorë për evalvimin e zbatimit të Strategjisë nacionale.

(4) Në përpilimin e Strategjisë nacionale marrin pjesë institucione publike nga sfera e kultures, arsimit të lartë dhe institucione shkencore, shoqata të qytetarëve nga sfera e kultures dhe përfaqësues të skenës së pavarur kulturore.

(5) Propozim-strategjia nacionale vihet në debat publik para se të dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonise.

(6) Ministrinë, në kuadër të kompetencave të tyre ligjore, marrin pjesë në realizimin e Strategjisë nacionale.

(7) Mjetet për realizimin e Strategjisë nacionale sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonise.

(8) Strategjia nacionale dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonise, së paku gjashtë muaj para kalimit të vlefshmërisë së Strategjisë paraprake nacionale.

(9) Për realizimin e aktiviteteve në pajtim me planin aksional të Strategjisë nacionale, Ministria e Kultures një herë në vit dorëzon raport në Kuvendin e Republikës së Maqedonise, për informim."

Neni 3

Në nenin 10 paragrafi (1) fjala "program" zëvendësohet me fjalën "strategji".

Paragrafi (3) fshihet.

Neni 4

Pas nenit 11-a shtohet nen i ri 11-b, si vijon:

"Neni 11-b

(1) Artisti dhe punetori profesional nga sfera e mbrojtjes së trashëgimise kulturore që ka realizuar të drejte pensioni dhe është fitues i:

- cmimit shtetëror "11 Tetori" për veper jetesore ose,
- cmimit shtetëror "11 Tetori" për realizime shumevjecare në kulture dhe art ose,
- cmimit shtetëror "Shen. Klimenti i Ohrit" për realizime shumevjecare në kulture dhe art ose,
- cmimit shtetëror "23 Tetori" për realizime shumevjecare në kulture, ka të drejte kompensimi

mujor në para, në shume të dallimit ndërmjet pensionit që e realizon edhe pensionit më të lartë në Republikën e Maqedonise në vitin e kaluar, për vitin rrjedhes.

(2) Nëse artisti, respektivisht punetori profesional nga fusha e mbrojtjes së trashëgimise kulturore është fitues i njerit të cmimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, e në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk e ka realizuar të drejtën e pensionit, të drejtën e kompensimit mujor në para nga paragrafi (1) i këtij neni, do ta fitojë me ditën e realizimit të së drejtës së pensionit.

(3) Nëse artisti, respektivisht punetori profesional nga fusha e mbrojtjes së trashëgimise kulturore e ka realizuar të drejtën e pensionit, e njerin nga cmimet nga paragrafi (1) i këtij neni e merr pas dites së hyrjes në fuqi të këtij ligji, të drejtën e kompensimit mujor në para nga paragrafi (1) i këtij neni, do ta fitojë me ditën e marrjes së cmimit.

(4) Të drejtën nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të këtij neni, artisti, respektivisht punetori profesional në fushën e mbrojtjes së trashëgimise kulturore, e realizon me paraqitjen e kërkesës në Ministrinë e Kultures, me të cilën parashtrohet edhe deshmi për lartësinë e pensionit dhe deshmi se është fitues i një prej cmimeve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Për realizimin e të drejtës nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të këtij neni, vendos ministri i Kultures.

(6) Kompensimi paguhet me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonise nepermjet Ministrisë së Kultures, duke llogaritur nga dita e marrjes së të drejtës për kompensim në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni, deri në fund të jetës."

Neni 5

Në nenin 57 fjalet: "shoqata kompetente e autoreve për realizim kolektiv të" zëvendësohen me fjalet: "organizatat për menaxhim kolektiv të".

Neni 6

Në nenin 65 paragrafi (1) fjala "program" zëvendësohet me fjalën "strategji".

Neni 7

Në nenin 68 paragrafi (2) fjala "kontrolli" zëvendësohet me fjalën "mbikeqyrja".

Në paragrafin (4) në fjaline e pare, fjala "kontrolli" zëvendësohet me fjalën "mbikeqyrja".

Neni 8

Në nenin 82 paragrafi (2) fjala "ligji" zëvendësohet me fjalet: "Ligji për nepunes shtetërore dhe Ligji për mbikeqyrje inspektuese".

Në paragrafin (2) pika 1 ndryshohet si vijon:

"ta kete kryer Fakultetin Juridik ose Ekonomik;"

Në paragrafin (3) fjala "Udheheqes" zëvendësohet me fjalet " Inspektor i pergjithshem, respektivisht kryesor".

Pas paragrafit (3) shtohen edhe dy paragrafe të rinj (4) dhe (5), si vijojne:

"(4) Inspektori, punet e mbikeqyrjes inspektuese i kryen në njesi të vecante organizative të Ministrisë së Kultures.

(5) Ministri i Kultures miraton Program vjetor të punes së njesise organizative për mbikeqyrje inspektuese, deri në fund të dhjetorit të vitit rrjedhes për vitin e ardhshem."

Neni 9

Neni 84 ndryshohet si vijon:

"(1) Inspektori e kryen mbikeqyrjen e punes së institucioneve dhe personave tjere juridike që kryejne veprimtari në fushen e kultures, si dhe subjekteve tjera, puna e të cileve i nenshtrohet mbikeqyrjes në perputhje me rregullat nga sfera e kultures, për pune nga kultura (në tekstin e metejme: subjekte të mbikeqyrjes).

(2) Inspektori mund të kryejë mbikeqyrje inspektuese pa e njoftuar subjektin e mbikeqyrjes për fillimin e kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, si dhe në mungese të drejtorit dhe personit pergjegjes në subjektin e mbikeqyrjes.

(3) Për ankese ndaj aktvendimit të inspektorit vendos komisioni i vecante prej dy anetareve dhe kryetarit, të emeruar nga ministri i Kultures. Kryetari i Komisionit eshte nga radhet e nepunesve shtetore udheheqes në Ministrine e Kultures me titull udheheqes i Sektorit dhe me Fakultet Juridik të kryer, kurse dy anetaret tjere jane jurist i diplomuar dhe ekonomist i diplomuar, me titull jo më të ulet se udheheqes i seksionit.

(4) Komisioni vendos në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimi të ankese."

Neni 10

Neni 85 ndryshohet si vijon:

"Për menjanimin e parregullsive të konstatuara, inspektori ka të drejte dhe detyrim që subjektit të mbikeqyrjes:

1) t'ia tregojë parregullsite e konstatuara dhe t'i urdherojë që të ndermarre masa dhe aktivitete adekuate për menjanimin e parregullsive në afat prej më së shumti 30 ditesh dhe

2) perkohesisht t'ia marre sendet dhe mjetet me të cilat eshte kryer vepra penale ose kundervajtja, kur me rregull nga sfera e kultures parashihet mundesia për marrjen e perkohshme të sendeve."

Neni 11

Neni 85-a ndryshohet si vijon:

"Sendet e marra perkohesisht ruhen në lokal të vecante në Ministrine e Kultures të percaktuar për ruajtjen e sendeve të marra perkohesisht, që eshte i siguruar në menyre adekuate në aspekt hapesinor dhe teknik për ruajtjen e sendeve."

Neni 12

Nenet 86, 87 dhe 88 fshihen.

Neni 13

Në nenin 91 paragrafi (1) alineja 3 numri në kllapa "91" zevendesohet me numrin "93".

Neni 14

Në nenin 91-a paragrafi (1) pas alinese 2 shtohet alineja e re 3, si vijon:

"-nuk lidh marreveshje për realizimin publik të veprave nga sfera e kultures, në pajtim me kete ligj (neni 58),".

Neni 15

Procedurat e mbikeqyrjes inspektuese të filluara para dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji, do të perfundojne sipas dispozitave të ligjit që ka qene në zbatim në ditën e fillimit të mbikeqyrjes.

Neni 16

Strategjia nacionale nga neni 2 i ketij ligji do të miratohet në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç nenit 4 të këtij ligji që do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2012, ndërsa nenet 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 prilli 2011.